

VENDIM
Nr. 164, datë 20.6.2022

**MBI TRANSFERIMIN E PLOTË TË LICENCËS SË SHOQËRISË “HERA” SHPK,
NR. 49, SERIA NPM07P, DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT NR. 61, DATË
2.11.2007, “PËR NDËRTIM, INSTALIM, SHFRYTËZIMIN DHE PRODHIMIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALE ME ERË (PROJEKTI ‘KAPPET’), I
NDRYSHUAR**

(ndryshuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 268, datë 14.10.2022)

Në mbështetje të neneve 16 dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, ‘Për sektorin e energjisë elektrike’, i ndryshuar; neneve 13; 17 pikat 1, 2 dhe 4, të rregullores ‘Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike’, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; dhe nenit 15 të rregullores ‘Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s’, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.6.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizime dhe Mbikëqyrjes, me nr. 925/1 prot., datë 14.6.2022, “Mbi transferimin e plotë të licencës së shoqërisë ‘Hera’ sh.p.k., me nr. 49, seria NPM07P, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 2.11.2007, i ndryshuar, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti ‘KAPPET’), me kapacitet instaluar 150 MW, për një afat 30-vjeçar”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 240, datë 2.12.2021, vendosi:

1. Të fillojë procedurën për transferimin e plotë të licencës së shoqërisë “Hera” sh.p.k., me nr. 49, seria NPM07P, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 2.11.2007, i ndryshuar, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti ‘KAPPET’), me kapacitet të instaluar 150 mw, për një afat 30-vjeçar.

2. Vendimi përfundimtar për transferimin e licencës së shoqërisë “Hera” sh.p.k. do të merret pasi Bordi i ERE-s të jetë shprehur në lidhje me shtyrjen ose jo të afateve të plotësimit të kushteve të vendimit nr. 61, datë 2.11.2007, i ndryshuar.

- Në lidhje me pikën 2 të dispozitivit sipërcituar, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 250, datë 13.12.2021, vendosi ndër të tjera:

1. Të zgjasë me 9 (nëntë) muaj afatin e plotësimit të kushteve të vendosura në pikat 3.1, 3.2 dhe pikën 4, gjerat “a” dhe “b” (leja e mjedisit, dokumentacioni pronësor, miratimi nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale dhe dokumentacioni përkatës.

Në këto rrethana vlerësojmë që transferimi i licencës së prodhimit të energjisë elektrike nga shoqëria “Hera” sh.p.k. te shoqëria “SOT–AL” sh.p.k., t’i nënshtrohet vendimmarrjes së Bordit të ERE-s.

- Në vijim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 240/2021, “Për fillimin e procedurës së transferimit të licencës së shoqërisë ‘Hera’ sh.p.k., me nr. 49, seria NPM07P”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 2.11.2007, i ndryshuar, me shkresën nr. 6/27 prot., datë 2.12.2021, u bë njoftimi në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 17.12.2021), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Pas vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për fillimin e procedurës për transferimin e licencës së shoqërisë “Hera” sh.p.k., midis ERE-s dhe shoqërisë kanë vijuar korrespondencat nëpërmjet shkresave:

- Me shkresën nr. 1083/2 prot., datë 7.12.2021, ERE i është drejtuar shoqërive “Hera” sh.p.k. dhe “SOT–AL” sh.p.k. me “Njoftim vendimi” dhe ka kërkuar që në vijim të parashikimit të nenit 17, pika 5, të rregullores, duhet të paraqesë në ERE një aplikim sipas pikës 2, të nenit 17, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Shoqëria “SOT–AL” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1083/3 prot., datë 30.12.2021 dhe shkresën nr. 3/3 prot., datë 21.1.2022, ka përcjellë në ERE dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria “Hera” sh.p.k. me shkresën nr. 44 prot., datë 17.1.2021, protokolluar në ERE me nr. 65/1 prot., datë 19.1.2022, ka përcjellë në ERE, formatin e aplikimit të saktësuar.

- ERE iu drejtua shoqërisë me e-mailin zyrtar të datës 16.3.2022, për plotësime shtesë.
 - Shoqëria ka depozituar dokumentacionin shtesë me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 65/5 prot., datë 18.3.2022; nr. 65/6 prot., datë 18.3.2022 dhe nr. 65/7 prot., datë 18.3.2022.
 - ERE, me vendimin nr. 48, datë 23.3.2022 vendosi të shtyjë me 30 ditë pune vendimarrjen e saj përfundimtare për kërkesën e shoqërisë “Hera” sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës, për të marrë kohën e mjaftueshme për të shqyrtuar dokumentacionin e depozituar me shkresat e sipërcituara.
 - Shoqëria u njoftua për vendimarrjen e Bordit të ERE-s me shkresën nr. 65/9 prot., datë 9.3.2022.
 - Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 103, datë 9.5.2022, i ndryshuar, vendosi të shtyjë me 30 ditë punë vendimarrjen finale për këtë transferim, me arsye sqarimin e çështjeve që lidhen me rregullimin e pronësisë dhe financimin e projektit “KAPPET”.
 - ERE iu drejtua shoqërive “Hera” sh.p.k. dhe “SOT-AL” sh.p.k., me shkresën nr. 65/12 prot., datë 13.5.2022, duke i njoftuar shtyrjen e afatit të ERE-s për t’u shprehur për transferimin e plotë të licencës, si dhe duke i ftuar për pjesëmarrje në seancën dëgjimore të datës 19.5.2022, për të diskutuar konkretisht çështjet që lidhen me rregullimin e pronësisë dhe financimin e projektit “KAPPET”.
 - Dokumentacioni i këtij aplikimi rezulton i plotësuar sipas kërkesave të nenit 17, pikat 1, 2 dhe 4 e rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.
 - Për sa më sipër vlerësojmë që shoqërisë “SOT-AL” sh.p.k. t’i transferohet licenca nr. 49, seria NPM07P, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 2.11.2007, në mënyrë që t’i jepet mundësia për të plotësuar kushtet e mësipërme brenda afatit të përcaktuar nga Bordi i ERE-s në vendimin nr. 250, datë 13.12.2021 i cili ka vendosur, të zgjasë me 9 (nëntë) muaj afatin e plotësimit të kushteve të vendosura në pikat 3.1, 3.2 dhe pikën 4, germa “a” dhe “b” (leja e mjedisit, dokumentacioni pronësor, miratimi nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale dhe dokumentacioni përkatës), afat i cili përfundon në datën 13.9.2022.
 - Së bashku me licencën nr. 49, seria NPM07P, transferohen te shoqëria “SOT-AL” sh.p.k. edhe të drejtat dhe detyrimet që shoqëria “Hera” sh.p.k. ka në kuptim të kësaj licence dhe vendimit nr. 250, datë 13.12.2021 “Mbi rishikimin e vendimit nr. 112, datë 26.4.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Hera” sh.p.k., për rishikimin e vendimit nr. 34, datë 4.2.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Hera” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 61, datë 2.11.2007, i ndryshuar”, i cili ka shtyrë me 9 (nëntë muaj) afatin e plotësimit të kushteve respektive të licencimit.
 - Shoqëritë “Hera” sh.p.k. dhe “SOT-AL” sh.p.k. kanë kryer pagesën e aplikimit për transferimin e licencës në zbatim të aneksit A, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.
- Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin e plotë të licencës së shoqërisë “Hera” sh.p.k., me nr. 49 Seria NPM07P, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 2.11.2007, i ndryshuar, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti “KAPPET”)”, me kapacitet të instaluar 150 mw, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që shoqëria “SOT-AL” sh.p.k. të plotësojë kushtet e vendimit nr. 61, datë 2.11.2007, i ndryshuar brenda datës 13.9.2022.

2. Shfuqizuar.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

